



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 17, Datë 31.01.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË  
“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” SH.P.K., NR. 277, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË  
E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E  
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 38, DATË 18.03.2015.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma ç) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma d); nenit 5, pika 1, gërma d); nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 24/3 Prot, datë 22.01.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 Prot., datë 17.01.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 04.11.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42304017T.
- Në bazë të nenit 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, kërkesa për rinovimin e licencës nga aplikanti paraqitet : Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Referuar sa më sipër konstatohet se shoqëria “Albanian Energy Supplier” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.
- Aplikimi i shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të përcjellë jo në formën e kërkuar nga ligji e që ka të bëjë me:

Neni 9, pika 2

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).
  - Do ti kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE Vërtetimin e Gjykatës dhe të Prokurorisë për përfaqësuesen ligjore të shoqërisë.

Neni 9, pika 4.7

- **gërma “b”** (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie)
  - Shoqëria ka deklaruar të njëjtin kapital financiar për qëllime të aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit dhe asaj të tregtimit. Do t’i kërkohej shoqërisë të informojë ERE në lidhje me kapitalin financiar të parashikuar për ushtrimin e secilën veprimtari më vete.
- **gërma “c”** (Lista e kontratave të mëparshme, të realizuara, nëse ka pasur).
  - Shoqëria në plotësim të kësaj kërkesë të rregullores ka listuar disa data kontratash, por jo të dhënat përkatëse të këtyre kontratave.
- **gërma “d”** (Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave).
  - Do t’i kërkohej shoqërisë të përcjellë në ERE, informacion të detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre kontratave.
- **gërma “e”** (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).
  - Do ti kërkohej shoqërisë të përcjellë në ERE informacion në lidhje me Sistemin IT.
- **gërma “g”** (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do ti ofrohen klientëve).

- do t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE dokumentacionin në lidhje me disponimin e zyrave.

*Për sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e Energjisë Elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.*

- Rezulton se shoqëria aplikuese nuk është debitore sa i përket pagesave të rregullimit në ERE.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë "Albanian Energy Supplier" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 277, Seria FK15, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 38, datë 18.03.2015.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**